

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj

**Pasqyrat Financiare
me dhe per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2017**

r

RAPORT I AUDITUESVE TE PAVARUR

Drejtuar: Asamblese se Aksionereve te Shoqerise
"BRUNEL ENERGY EUROPE B.V. Dege e Shoqerise se Huaj"

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "BRUNEL ENERGY EUROPE B.V. Dege e Shoqerise se Huaj", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën **31 Dhjetor 2017**, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën **31 Dhjetor 2017**, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (*Kodi i BSNEPK*) së bashku me kërkesat etike dhe ligjore që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

Ne nuk kemi përcaktuar ndonjë çështje si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.


Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.


ELTON MERSINI
Eksperi Kontabël i Autorizuar
NIPT K33322201U
ELBASAN
Lic. Prof: Nr. 170 Dt. 21.09.2007
Mobile: ++355 (0) 692056750
Elton MERSINI
Auditues Ligjor

Adresa:

**Lagjja: Sul Papri, Rr: 25 Nentori, Nd3, H13, Ap 16,
Elbasan, ALBANIA**


EDI STAJA
Eksperi Kontabël i Autorizuar
NIPT K82604209G
ELBASAN
Lic. Prof: Nr. 171 Dt. 21.09.2007
Mobile: ++355 (0) 692054944
Edi STAJA
Auditues Ligjor

Adresa:

**Lagjja: 28 Nëntori, Rr: Abdyl Frashëri, Nr 28,
Elbasan, ALBANIA**

Date: 30 Mars 2018

PERMBAJTJA:	FAQE
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA PERMBLEDHESE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	5
PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE	6
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE	7-21

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj**Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2017***(Shumat ne LEK)*

	Shenimet	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
Aktivitet			
Aktivitet afatgjata			
Totali i aktiveve afatgjata		-	-
Aktivitet afatshkurtra			
Llogari te arketueshme	5	23,086,110	16,870,874
Tatimi mbi fitimin i arketueshem	6	1,637,636	2,429,327
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	7	95,105,543	270,862,211
Totali i aktiveve afatshkurtra		119,829,289	290,162,412
Totali i aktiveve		119,829,289	290,162,412
Detyrime dhe kapitali			
Kapitali			
Humbja e akumuluar		(10,629,070)	4,367,880
Humbja e vitit		(3,658,995)	(14,996,950)
Totali i kapitalit		(14,288,065)	(10,629,070)
Detyrime afatgjata			
Fonde te marra nga Shoqeria Meme	8	113,250,253	259,027,570
Totali i detyrimeve afatgjata		113,250,253	259,027,570
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime tatimore	9	5,063,338	5,571,498
Shpenzime te perlllogaritura	10	731,225	285,080
Llogari te pagueshme	11	7,256,057	26,713,233
Llogari te pagueshme ndaj punonjesve	12	7,816,481	9,194,100
Totali i detyrimeve afatshkurtra		20,867,101	41,763,911
Totali i detyrimeve		134,117,354	300,791,481
Totali i detyrimeve dhe i kapitalit		119,829,289	290,162,412

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 21, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga perfaqesuesi ligjor i Shoqerise Brunel Energy Europe B.V-Dege e Shoqerise se Huaj me 30 mars 2018 dhe u nenshkruan nga:

Perfaqesuesi Ligjor



Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj**Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te tjera Permbledhese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(Shumat ne LEK)*

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Te ardhurat			
Te ardhura nga sherbimet	13	183,197,245	189,276,405
Te ardhura te tjera	13	14,710	315,326
Totali i te ardhurave		183,211,955	189,591,731
Shpenzimet			
Shpenzime personeli	14	(151,504,300)	(154,813,025)
Shpenzime operative	15	(32,769,948)	(29,564,609)
Totali i shpenzimeve		(184,274,248)	(184,377,634)
Fitim (humbja) nga aktiviteti operacional		(1,062,293)	5,214,097
Fitim (humbja) nga kurset e kembimit			
Humbja nga kurset e kembimit	16	(1,900,784)	(20,211,047)
Humbja neto nga kurset e kembimit		(1,900,784)	(20,211,047)
Humbja para tatimit		(2,963,077)	(14,996,950)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	695,918	-
Humbja neto		(3,658,995)	(14,996,950)
Te ardhura te tjera permbledhese per periudhen		-	-
Totali i te ardhurave permbledhese		(3,658,995)	(14,996,950)

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te tjera Permbledhese duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 21 te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj**Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(Shumat ne LEK)*

	Totali
Gjendja me 1 janar 2016	4,367,880
Humbja neto e vitit	(14,996,950)
Te ardhura te tjera permbledhese	-
Gjendja me 31 dhjetor 2016	(10,629,070)
Gjendja me 1 janar 2017	(10,629,070)
Humbja neto e vitit	(3,658,995)
Te ardhura te tjera permbledhese	-
Gjendja me 31 dhjetor 2017	(14,288,065)

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 21, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj

Pasqyra e Rrjedhes se Parase per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat ne LEK)

Shenimet	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Rrjedha e parase nga (perdorimi ne) veprimtarite e shfrytezimit		
Humbja para tatimit	(2,963,077)	(14,996,950)
Ndryshimet ne kapitalin punues:		
Rritje ne llogarite e arketueshme	5 (6,215,236)	(16,198,577)
Ulje ne tatimin mbi fitimin e arketueshem	6 791,691	-
Rritje ne te ardhura te perlllogaritura	-	66,554,823
Rritje (ulje) ne detyrime tatimore	9 (508,160)	1,424,389
Rritje (ulje) ne shpenzime te perlllogaritura	10 446,145	(5,668,951)
Rritje (ulje) ne llogarite e pagueshme	11 (19,457,177)	25,231,386
Rritje (ulje) ne llogari te pagueshme ndaj punonjesve	12 (1,377,618)	9,194,099
Paraja e gjeneruar (perdorur ne) nga veprimtarite e shfrytezimit	(29,283,432)	65,540,220
Tatimi mbi fitimin i paguar	(695,918)	(2,429,327)
Paraja neto e gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtarite e shfrytezimit	(29,979,350)	63,110,893
 Rrjedha e parase gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtarite e investimit		
Paraja e gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtarite e investimit	-	-
 Rrjedha e parase gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtarite e financimit		
Fonde te marra nga (te dhena tek) Shoqeria Meme	8 (145,777,318)	207,622,363
Paraja e gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtarite e financimit	(145,777,318)	207,622,363
Rritja (Ulja) neto e mjeteve monetare	(175,756,668)	270,733,256
Mjetet monetare me 1 janar 2017	7 270,862,211	128,955
Mjetet monetare me 31 dhjetor 2017	7 95,105,543	270,862,211

Pasqyra e Rrjedhes se Parase duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 21, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

1. TE PERGJITHSHME

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj (referuar ne vijim si “Dega”) eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne daten 18 maj 2015, si dege e shoqerise se huaj, e cila vepron sipas Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar. Perfagesues ligjore te Deges jane Z. Johan Hardy Flohr dhe Z. Peter Aleksander De Laat, te dy shtetas hollandez. Shoqeria Meme eshte Brunel Energy Europe B.V., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara me kapital ne shumen 18,000 Euro, e themeluar ne Hollande me 20 shkurt 2003.

Objekt i veprimtarise se Deges eshte te ofroje sherbime dhe keshillime per sipermarrjet industriale, vecanerisht sipermarrjet qe ushtrojne veprimtari ne fushen e industrise se vajit dhe gazit, kimise, industrise petrokimike dhe industrise se energjise.

Bazuar ne nenin 41 te Ligjit “Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar”, Shoqeria detyrohet te kryje auditimin ligjor te Pasqyrave Financiare, perpara publikimit te tyre.

Gjate vitit 2017, Dega ka pasur marredhenie kontraktuale me Trans Adriatic Pipeline AG, Dega ne Shqiperi (ketej e tutje referuar si “TAP”) dhe me Technip Italy S.p.A, Dega ne Tirane (ketej e tutje referuar si “Technip”).

Dega me 31 dhjetor 2017 ka deklaruar 5 punemarres (31 dhjetor 2016: 5 punemarres).

2. BAZA E PERGATITJES

(a) Deklarata e perputhshmerise se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Shumat ne pasqyrat financiare jane te shprehura ne monedhen shqiptare Lek (LEK), qe eshte edhe monedha funksionale e Deges.

ZBATIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA

(d) Standarde dhe interpretime ne fuqi per periudhen raportuese

Ndryshimet e meposhtme te standardeve ekzistuese te publikuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare jane ne fuqi per periudhen raportuese:

- **Ndryshime ne SNK 7 “Pasqyra e Levizjes se Parase”**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates 1 janar 2017);

2. BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)

(d) Standarde dhe Interpretime ne fuqi per periudhen raportuese (Vazhdim)

- **Ndryshime ne SNK 12 “Tatimi mbi te Ardhurat”** – Njohja e aktiveve tatimore te shtyra per humbjet e paralezuara joefektive per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates 1 janar 2017);
- **Ndryshime ne SNRF 12 si pasoje e “Permiresimeve te SNRF-ve (cikli 2014-2016)”** rezultuar nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me nje pikepamje per te eliminuar mosperputhjet dhe per te qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do te jene te aplikueshme per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates 1 janar 2017).

Keto ndryshime ne standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk kane ndikuar ne politikat kontabel te Deges.

(e) Standarde dhe interpretime ne publikim, por akoma jo ne fuqi

Ne daten e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare standardet, permiresimet dhe interpretimet e meposhtme ishin publikuar, por akoma nuk ishin ne fuqi.

- **SNRF 9 “Instrumentat financiare”** (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2018);
- **SNRF 15 “Te ardhurat nga kontratat me klientet”** dhe ndryshime te metejshme (efektiv me ose pas dates 1 janar 2018);
- **SNRF 16 “Qirate”** (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2019);
- **Ndryshimet ne SNRF 2 “Pagesat bazuar ne Aksione”** - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve te pagesave me baze aksionet (efektiv me ose pas 1 janarit 2018);
- **Ndryshimet ne SNRF 4 “Kontratat e sigurimit”** - Aplikimi i SNRF 9 “Instrumentat financiare” me SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” (ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 “Instrumentat financiare” eshte aplikuar per here te pare);
- **Ndryshimet ne SNRF 9 “Instrumentat Financiare”** – Vecorite e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv me ose pas dates 1 janar 2019);
- **Ndryshime ne SNRF 10 “Pasqyrat financiare te konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime ne pjesemarrje dhe siperemarrje te perbashketa”** - Shitja apo kontributi i pasurive ndermjet nje investitori dhe bashkepunetor te tij ose siperemarrje te perbashket (hyrja ne fuqi eshte shtyre per nje kohe te papercaktuar deri kur te mbaroje projekti kerkimore mbi metodologjine e aktiveve);
- **Ndryshimet ne SNK 28 “Investimet ne pjesemarrje dhe siperemarrjet e perbashketa”** - interesa afatgjate ne Pjesemarrje dhe Nderemarrje te Perbashketa (efektiv me ose pas dates 1 janar 2019);
- **Ndryshime ne SNRF 1 dhe SNK 28 si pasoje e “Permiresimeve te SNRF-ve (cikli 2014-2016)”** rezultuar nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me nje pikepamje per te eliminuar mosperputhjet dhe per te qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do te jene te aplikueshme per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates 1 janar 2018);

2. BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)

(e) Standarde dhe interpretime ne publikim, por akoma jo ne fuqi (Vazhdim)

- **Ndryshime ne SNK 40 “Investime ne aktive afatgjata materiale”** - Transferimet e investimeve te aktiveve afatgjata materiale (efektiv ne periudhat vjetore qe fillojne me ose pas dates 1 janar 2018);
- **KIRFN 22 “Transaksionet valute dhe Konsiderata per avancat”** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me/pas 1 janarit 2018);
- **KIRFN 23 “Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi te Ardhurat”** efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2018).

Dega ka zgjedhur te mos zbatoje keto standarde, rishikime dhe interpretime perpara dates se tyre efektive. Dega parashikon se pershtatja e ketyre standardeve nuk do te kete impakt material ne pasqyrat financiare te Deges ne periudhen fillestare te zbatimit.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

(a) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Dega nuk ka patur aktive afatgjata materiale. Megjithate, sipas politikave kontabel qe ajo zbaton zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvleresimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi (shih politiken kontabel 3(c)). Kur pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si elemente te vecanta te aktiveve afatgjata.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren e mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te ardhme qe i atribuohen atij elementi t'i perkasin Deges, dhe nese kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje gjate jetes se dobishme te aktiveve. Metodot e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nese eshte e konsiderueshme) rivleresohen ne daten e raportimit.

(b) Inventaret

Dega nuk ka mbajtur inventar gjate vitit 2017. Megjithate, sipas politikave kontabel qe ajo zbaton inventaret maten me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Kosto percaktohet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme eshte çmimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit minus koston e vleresuar per perfundimin dhe realizimin e shitjes. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatesc njihet. Shuma e renies ne vlere te inventareve deri ne vleren e realizueshme neto si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(c) Renia ne vlere e aktiveve jofinanciare

Ne çdo date raportimi Dega rishikon vleren kontabel te aktiveve jofinanciare, perveç inventarit dhe aktiveve tatimore te shtyra, per te percaktuar nese ka tregues per reniet e vleres. Nese ka tregues te tille, atehere vleresohet vlere e rikuperueshme e aktivitetit ne menyre qe te percaktohet renia ne vlere. Vlere e rikuperueshme e nje aktivi ose njesise gjeneruese te parase eshte vlere me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte minus koston e shitjes.

Per percaktimin e vleres ne perdorim, skontoohen rrjedhat e ardhshme te parase duke perdorur normen e skontimit para tatimit, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqeve specifike te aktivitetit. Per qellime te testimit te renies ne vlere, aktiviteti grupohet se bashku ne grupin me te vogel te tyre i cili gjeneron rrjedha parash nga perdorimi i vazhdueshem i tyre dhe qe jane te pavarura nga rrjedhat e parase te aktiveve ose grupeve te tjera te aktiveve ("njesia gjeneruese e parase").

Nje humbje nga renia ne vlere njihet nese vlere e mbetur e nje aktivi apo e njesise se tij gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga renia ne vlere njihen ne pasqyren e fitimit ose humbjes.

Humbjet nga renia ne vlere, qe jane njohur ne periudhat e meparshme, vleresohen ne çdo date raportimi nese ka evidence qe humbja eshte ulur ose nuk ekziston me.

(d) Instrumentet financiare

Dega mban vetem instrumente financiare joderivative, qe perfshijne llogari te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, hua dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare joderivative jane matur fillimisht me vleren e drejte plus koston e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejte me pervetesimin e tyre.

Nje instrument financiar njihet ne rast se Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktiviteti financiar nuk njihet nese te drejtat kontraktuale te Deges ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktivi financiar mbarojne ose nese Dega i transferon aktivitetin financiar nje pale tjetere, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te nje aktivi financiar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh. daten ne te cilen Dega zotohet te bleje ose te shese aktivitetin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e Deges te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane anuluar.

Pas njohjes fillestare instrumentet financiare joderivative vleresohen si me poshte:

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat ne llogari rrjedhese ne banka, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere dhe perdoren nga Dega ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(d) Instrumentet financiare (Vazhdim)

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara me humbjet nga renia ne vlere.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

Huamarrjet

Dega ka marre financime (hua) nga Shoqeria Meme, te cilat njihen fillimisht me vleren e drejte. Huamarrjet mbarthen ne vijim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta financiare te tjere joderivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga renia ne vlere.

Metoda e interesit efektiv eshte nje metode per llogaritjen e koston se amortizuar te nje aktivi ose detyrimi financiar dhe per shperndarjen e te ardhurave ose shpenzimeve te interesit pergjate periudhes perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe skanton plotesisht pagesat e ardhshme te vleresuara pergjate jetes se pritshme te instrumentit financiar ose, kur eshte e pershtatshme, pergjate nje periudhe me te shkurter me vleren e mbartur neto te aktivitetit ose detyrimit financiar.

Kontabiliteti per te ardhurat dhe shpenzimet financiare shtjellohet ne politiken kontabel 3(g).

Renia ne vlere e aktivitetit financiar

Nje aktiv financiar konsiderohet te jete i zhvleresuar nese nje fakt objektiv tregon qe nje ose me shume ngjarje kane patur nje ndikim negativ ne flukset e ardhshme monetare te aktivitetit. Nje humbje nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar, llogaritet si diference midis vleres neto dhe shumes aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara te parase te skontuara me normen efektive origjinale te interesit.

Aktivet financiare te rendesishme individualisht i nenshtrohen testimit per zhvleresim mbi baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare jane te vleresuara se bashku, ne grupe qe shfaqin te njejtat karakteristika te rrezikut te kredise. Te gjitha diferencat nga zhvleresimi njihen si fitim ose si humbje. Nje humbje nga zhvleresimi kthehet mbrapsht ne qofte se kthimi mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi humbja nga zhvleresimi eshte njohur. Kthimi njihet ne pasqyren fitimit ose humbjes.

(e) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Dega paguan kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension.

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(e) Perfitimet e punonjesve (Vazhdim)

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore (vazhdim)

Qeveria Shqiptare eshte pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Deges ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Leje vjetore te paguara

Dega njej si detyrim vleren e paskontuar te kostove te vleresuara ne lidhje me lejet vjetore qe pritet te paguhet ne kembim per sherbimin e punonjesve gjate periudhes.

(f) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

Shpenzimet e qirase

Shpenzimet e qirase operative jane ngarkuar ne fitim ose humbje ne menyre lineare gjate periudhes se qirase.

(g) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi prej llogarive ne banka dhe fitimet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit humbjet neto nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje.

(h) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Dega nuk ka njohur tatim te shtyre ne pasqyren e Pozicionit Financiar pasi nuk ka identifikuar diferenca te perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe bazes tatimore.

Detyrimi tatimor i shtyre njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme. Shuma e tatimit te shtyre eshte llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit. Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per aq sa eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem te jete i disponueshem kundrejt te cilit aktiv i mund te perdoret. Aktiv i tatimor i shtyre zvogelohet per aq sa nuk eshte e mundur te realizohet perfitim fiskal

3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

(i) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet jomonetare te shprehuara me kosto historike nuk konvertohen. Diferencat nga kurset e kembimit nga elementet monetare njihen ne te ardhurat dhe shpenzimet e periudhes kur ato shfaqen.

Kurset e kembimit ne fund te periudhes se raportimit dhe periudhes parardhese te raportimit jane si vijon:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
EURO	132.95	135.23
GBP	149.95	157.56
USD	111.10	128.17

(j) Njohja e te ardhurave

E ardhura ne lidhje me kontraten me klientin eshte e njohur ne fitim ose humbje ne periudhen kur ofrohet sherbimi. Te ardhurat njihen ne baze te metodes kosto-plus sipas kushteve te kontrates.

4. VLERESIME THELBESORE KONTABEL DHE BURIMET KRYESORE TE VLERESIMIT TE PASIGURISE

Dega pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me SNRF, zbatimi i te cilave zakonisht kerkon gjykimin e drejtuesve gjate vleresimit te pozicionit financiar dhe rezultatit te Deges. Sipas SNRF, drejtimi i kerkohet te pershtase politikat kontabel me te pershtatshme per rrethanat e Deges, me qellim qe te beje nje paraqitje sa me te besueshme te pozicionit financiar, performances dhe flukseve monetare.

Ne percaktimin dhe zbatimin e politikave kontabel, zakonisht kerkohet gjykimi per zera per te cilet zgjedhja e politikave specifike, vleresimet ose supozimet kontabel qe do te ndiqeshin, do te ndikonin materialisht ne rezultatet e raportuara ose pozicionin e aktiveve neto te Deges, ne rast se me vone do te percaktohej qe nje zgjedhje tjeter do te ishte me e pershtatshme. Burimet me kritike te pasigurise detajohen si me poshte:

i) Te ardhurat e perlllogaritura per punen e kryer

Drejtimi perlllogarit te ardhurat per punen qe eshte kryer, por qe nuk eshte faturuar tek klienti ne çdo date raportimi. Te ardhura te tilla varen nga miratimi i klientit, bazuar ne specifikimet e kontrates dhe rregullimet qe kerkohen per perlllogaritjet e bera nga Dega kur klienti nuk pranon vleresimin e prezantuar nga drejtimi.

4. VLERESIME THELBESORE KONTABEL DHE BURIMET KRYESORE TE VLERESIMIT TE PASIGURISE (VAZHDIM)*ii) Rishikimi i renies ne vlere per aktivet materiale dhe inventaret*

SNRF kerkon qe drejtimi te kryeje teste vjetore per renien ne vlere te aktiveve te trupezuara, nese ngjarje apo ndryshime ne rrethana tregojne se vlere kontabel neto e nje aktivi nuk eshte e kthyeshme. Drejtimi i Deges kerkon rishikimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale te pakten ne baze vjetore per te pare nese nevojitet nje rishikim persa i perket renies ne vlere. Gjithesesi, aktivet materiale dhe inventaret nuk perbejne shuma te medha ne pasqyrat financiare.

iii) Percaktimi i vleres se drejte

Vlera e drejte e mjeteve monetare, llogarive te arketueshme dhe te pagueshme eshte afersisht e barabarte me vleren kontabel neto per shkak te maturimit te tyre afatshkurter.

5. LLOGARI TE ARKETUESHME

Llogarite e arketueshme me 31 dhjetor 2017 dhe me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Me	Me
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Te arketueshme tregtare:</i>		
Trans Adriatic Pipeline AG- Dege e Shoqerise Huaj	22,359,039	11,890,577
Brunel Italy S.r.l	307,170	312,438
Technip Italy SpA, Dega ne Tirane	-	4,088,057
<i>Te arketueshme tatimore:</i>		
Teprice kreditore e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore	37,112	83,923
<i>Te arketueshme nga punonjesit:</i>		
Parapagime te dhena punonjesve	382,789	495,879
Totali	23,086,110	16,870,874

Teprica kreditore e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore vjen si rezultat i mbipagesave te kryera gjate vitit si pasoje e pagesave te kontributeve te kryera nga Dega ne monedhe te huaj.

6. TATIMI MBI FITIMIN I ARKETUESHEM

Gjate vitit 2017, Dega ka parapaguar keste mujore te tatimit mbi fitimin ne vleren totale 1,036,101 Lek, te cilat se bashku me tepricen kreditore te ardhur nga periudha paraardhese (ne shumen 1,297,453 Lek) perbejne tepricen kreditore prej 2,333,554 Lek. Kesaj teprice kreditore i eshte zbritur detyrimi i tatimit te fitimit lindur per vitin 2017 ne vleren 695,918 Lek. Ne fund te periudhes Dega rezulton me gjendje kreditore te tatimit mbi fitimin ne shumen 1,637, 636 Lek. Ky shenim duhet te lexohet se bashku me shenimin 17.

Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj**Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)***7. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE**

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre me 31 dhjetor 2017 dhe me 31 dhjetor 2016 detajohen si me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
Llogari rrjedhese ne Pound Britanik – Raiffeisen Bank	43,343,623	79,514,857
Llogari rrjedhese ne Euro – Raiffeisen Bank	40,668,799	184,589,218
Llogari rrjedhese ne Lek – Raiffeisen Bank	11,093,677	6,758,264
Llogari rrjedhese ne Dollar – Raiffeisen Bank	(556)	(128)
Totali	95,105,543	270,862,211

8. FONDE TE MARRA NGA SHOQERIA MEME

Fonde te transferuara nga Brunel Energy Europe B.V (Shoqeria Meme) me 31 dhjetor 2017 dhe me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<i>Detyrime ndaj Shoqerise Meme:</i>		
Fonde te transferuara nga Brunel Energy Europe B.V	113,250,253	259,027,570
Totali	113,250,253	259,027,570

9. DETYRIME TATIMORE

Detyrime tatimore me 31 dhjetor 2017 dhe me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<i>Detyrime tatimore:</i>		
TVSH per t'u paguar	2,372,278	2,266,432
Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi	2,256,697	2,719,370
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	432,286	519,352
Provizione per gjoba tatimore	2,077	66,344
Totali	5,063,338	5,571,498

Detyrimet tatimore perfaqesojne detyrimet tatimore te Deges te lindura gjate muajit dhjetor 2017, te cilat jane shlyer ne muajin janar 2018.

10. SHPENZIME TE PERLLOGARITURA

Shpenzime te perllogaritura me 31 dhjetor 2017 dhe me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<i>Shpenzime te perllogaritura:</i>		
Shpenzime te perllogaritura per fatura te pamberritura	731,225	285,080
Totali	731,225	285,080

Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj

Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

10. SHPENZIME TE PERLLOGARITURA (VAZHDIM)

Ne llogarine "Shpenzime te perllogaritura" Dega ka regjistruar shpenzime te kryera per blerje gjate vitit 2017, faturat e te cilave jane marre gjate muajve te pare te vitit 2018.

11. LLOGARI TE PAGUESHME

Llogarite e pagueshme me 31 dhjetor 2017 dhe me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
Llogari te pagueshme:		
Deloitte Albania Sh.p.k	4,149,795	2,101,880
Brunel Energy Holding B.V	1,800,276	1,324,848
Brunel Energy Europe B.V	1,305,986	21,916,636
Brunel Italy S.r.l	-	1,051,808
e Adviser Sh.p.k	-	318,061
Totali	7,256,057	26,713,233

12. LLOGARI TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE

Llogari te pagueshme ndaj punonjesve me 31 dhjetor 2017 dhe me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
Te pagueshme ndaj punonjesve:		
Pagat neto	7,566,115	9,194,100
Per te tjera shpenzime	250,366	-
Totali	7,816,481	9,194,100

13. TE ARDHURAT

Te ardhurat per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 perbehen nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Te ardhura nga sherbimet	183,197,245	189,276,405
Te ardhura te tjera	14,710	315,326
Totali	183,211,955	189,591,731

Ne zerin "Te ardhura nga sherbimet" perfshihen te gjitha te ardhurat e gjeneruara nga sherbimet e kryera ne kuader te projektit per "TAP" dhe "Technip" gjate vitit 2017. Ne zerin "Te ardhura te tjera" perfshihen te ardhurat e krijuara si rezultat i korrigjimit/faljeve te gjobave tatimore te lindura ne sistemin informatik tatimor ne vitin 2016.

Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj**Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)***14. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzime personeli per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 perbehet nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shpenzime per paga	148,285,514	151,589,183
Shpenzime per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	3,218,786	3,223,842
Totali	151,504,300	154,813,025

Dega ka perlllogaritur, deklaruar dhe paguar paga dhe kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore" mesatarisht per 5 punonjes gjate vitit 2017.

15. SHPENZIME OPERATIVE

Shpenzimet operative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 perbehen nga zerat e meposhtem:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shpenzime te pergjithshme te alokuara	14,005,833	15,222,690
Shpenzime kontabiliteti dhe konsulence fiskale	6,141,971	3,744,965
Shpenzimi udhetimi	2,348,039	1,893,405
Shpenzime per personelin	2,337,096	3,669,779
Shpenzime manaxhimi	1,800,276	1,327,200
Shpenzime sigurimi	1,575,810	1,916,486
Penalite dhe kamatvonesa	1,357,041	310,021
Shpenzime auditimi	1,076,675	-
Shpenzime akomodimi	743,365	100,544
Shpenzime bankare	696,558	61,424
Shpenzime ligjore	433,210	798,674
Shpenzime perkthimi	149,516	-
Taksa vendore	65,350	67,000
Shpenzime te tatimit ne burim	34,313	-
Shpenzime noteriale	2,818	-
Shpenzime provizioni per gjoba tatimore	2,077	66,344
Sherbime konsulence	-	386,077
Totali	32,769,948	29,564,609

Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj**Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)***16. FITIM (HUMBJA) NGA KURSET E KEMBIMIT**

Fitim (humbja) qe rezulton nga ndryshimet ne kurset e kembimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 perbehet nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Fitimi nga kurset e kembimit	6,131,123	3,302,211
Humbja nga kurset e kembimit	(8,031,907)	(23,513,258)
<i>Humbja neto nga kurset e kembimit</i>	<i>(1,900,784)</i>	<i>(20,211,047)</i>
Humbja neto nga kurset e kembimit	(1,900,784)	(20,211,047)

17. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin detajohet si me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
Humbja para tatimit	(2,963,077)	(14,996,950)
Te ardhura te patatueshme	14,710	-
Shpenzime te panjohura	7,617,239	6,081,850
Fitimi i tatueshem	4,639,453	(8,915,099)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin ne normen 15%	695,918	
Tatimi mbi fitimin i parapaguar	2,333,554	2,429,327
Totali per t'u arketuar	1,637,636	2,429,327

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017, Dega rezulton me humbje ushtrimore, por me fitim fiskal si rezultat i dy elementeve: (i) Te ardhura te patatueshme ne shumen 14,710 Lek, te cilat perfaqesojne te ardhura nga falja/korrigjimi i gjobave te vendosura ne sistemin informatik tatimor ne vitin 2016 dhe te konsideruara si shpenzime te panjohura per qellime te tatimit mbi fitimin ne vitin fiskal 2016; dhe (ii) shpenzimeve te panjohura per vitin 2017 ne shumen 7,617,239 Lek.

Sipas legjislacionit fiskal shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin per vitin 2017 eshte 15% (2016: 15%). Deklarimet tatimore plotesohen ne baze vjetore, por fitimet ose humbjet e deklaruar per qellime tatimore mbeten te perkohshme deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat tatimore dhe regjistrimet e tatimpaguesve dhe leshojne nje vleresim perfundimtar.



Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj**Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)***18. SHPENZIME TE PANJOHURA**

Shpenzimet e panjohura per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 analizohen si me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shpenzime udhetimi	2,348,039	1,893,405
Shpenzime per personelin	2,337,096	3,659,628
Gjoha dhe shpenzime interesi	1,357,041	310,021
Shpenzime akomodimi	743,365	100,544
Humbje nga kurset e kembimit	702,806	-
Shpenzime administrative	92,502	35,444
Shpenzime te tatimit ne burim	34,313	-
Shpenzime provizione per gjoha tatimore	2,077	66,344
Shpenzime postare	-	16,464
Totali	7,617,239	6,081,850

19. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<i>Fonde te marra nga Shoqeria Meme:</i>		
Fonde te marra nga Brunel Energy Europe B.V.	113,250,252	259,027,570
Totali	113,250,252	259,027,570

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<i>Detyrime ndaj paleve te lidhura:</i>		
Brunel Energy Holding BV	1,800,276	1,324,848
Brunel Energy Europe BV	1,305,986	21,916,637
Brunel Italy S.r.l	-	1,051,808
Totali	3,106,262	24,293,293

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
<i>Sherbime te marra nga palet e lidhura:</i>		
Brunel Energy Europe BV	18,312,326	22,891,700
Brunel Energy Holding BV	1,800,276	1,327,200
Brunel Italy S.r.l	15,821	1,056,708
Totali	20,128,423	25,275,608

Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj

Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

19. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA (VAZHDIMI)

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
<i>Te arketueshme nga palet e lidhura:</i>		
Brunel Italy S.r.l	307,170	312,438
Totali	307,170	312,438

20. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Ky shenim permban informacion per ekspozimin e Deges ndaj rrezikut te kredise, rrezikut te likuiditetit dhe rrezikut te tregut. Rreziku i tregut perfshin rrezikun e normes se interesit dhe rrezikun e kurseve te kembimit.

Drejtimi ka pergjegjesi per ngritjen dhe kontrollin e nje plani te pergjithshem per manaxhimin e rrezikut.

(a) Rreziku i kredise

Me 31 dhjetor 2017 Dega nuk eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi i llogarive te arketueshme ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte i lidhur vetem me klientet vendas.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare perfaqeson nivelin maksimal te ekspozimit ndaj rrezikut te kredise. Niveli maksimal i ekspozimit ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte si me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017	Me 31 dhjetor 2016
Llogari te arketueshme dhe kredi te tjera tatimore	24,723,746	19,300,201
Mjete monetare dhe ekuivalentet e saj	95,105,543	270,862,211
Gjendja me 31 dhjetor 2017	119,829,289	290,162,412

(b) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku qe ndryshimet ne cmimet e tregut, si normat e interesit, kurset e kembimit dhe cmimet e kapitalit do te ndikojne ne te ardhurat apo ne vleren e instrumanteve financiare te Deges. Objektivi i manaxhimit te rrezikut te tregut eshte manaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj rrezikut te tregut brenda parametrave te pranueshem duke optimizuar kthimin.

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit eshte rreziku qe Dega mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Rreziku i likuiditetit eshte rrezik i qenesishem ne biznesin e Deges pasi disa aktive te blera apo detyrime te shitura mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Dega menaxhon rrezikun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhet me profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.

Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj

Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

*(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)***20. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdimi)**

	deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Totali
Llogari te arketueshme dhe tatimi mbi fitimin e arketueshem	24,723,746	-	-	24,723,746
Mjete monetare ne banke	95,105,543	-	-	95,105,543
	119,829,289	-	-	119,829,289
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera	(20,867,101)	-	(113,250,253)	(134,117,354)
	(20,867,101)	-	(113,250,253)	(134,117,354)
Rreziku i likuiditetit me 31 dhjetor 2017	98,962,188	-	(113,250,253)	(14,288,065)

(d) Rreziku i valutes

Dega ndermerr transaksione ne monedhe te huaj si pasoje e ekspozimit ndaj luhatjeve te kursit te kembimit. Ekspozimi ndaj kurseve te kembimit manaxhohet duke percaktuar nje politike midis te arketueshmeve dhe pagueshmeve. Vlerat kontabel te aktiveve dhe detyrimeve monetare te Deges sipas monedhave per vitin qe u mbyll me 31 dhjetor 2017 jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

	EUR	GBP	USD	LEK	Totali
Llogari te arketueshme dhe kredi tatimore	10,294,555	12,371,654	-	2,057,537	24,723,746
Mjete monetare ne banke	40,668,799	43,343,623	(556)	11,093,677	95,105,543
	50,963,354	55,715,277	(556)	13,151,214	119,829,289
Llogari te pagueshme dhe te tjera	(12,962,895)	(2,849,518)	-	(5,054,688)	(20,867,101)
Detyrime ndaj Shoqerise Meme	(78,796,708)	(11,446,912)	-	(23,006,632)	(113,250,252)
	(91,759,603)	(14,296,430)	-	(28,061,320)	(134,117,353)
Rreziku i kursit te kembimit me 31 dhjetor 2017	(40,796,249)	41,418,847	(556)	(14,910,106)	(14,288,065)

21. NGJARJE TE METEJSHME

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te metejshme pas dates se raportimit qe te kerkojne ndryshime apo rregullime te metejshme te pasqyrave financiare.

* * * * *